



Kolegji Riinvest

Zyra për planifikim akademik

## Menaxhimi i Projekteve KOMP601

Bartësi i lëndës:	Diana Lekaj
Email:	diana.lekaj@riinvest.net
Telefoni:	
Mësimdhënësit e Lëndës:	Fëllanza Avdimetaj

### Hyrje

Në këtë lëndë do të mësoni për menaxhimin të projekteve, nga të kuptuarit e ciklit të jetës së projektit tek përcaktimi prioriteteve dhe pritjeve e deri tek vlerësimi i kostove dhe raportimi i rezultateve. Ju do të zbuloni role e mjedise si dhe teknika të ndryshme të inicimit, planifikimit, ekzekutimit, kontrollit dhe përfundimit të projekteve. Kështu lënda do të japë një hyrje në menaxhimin e projekteve si dhe do të j'u aftësojë se si të zbatoni një projekt të mirëfilltë hap pas hapi. Në kuadër të kësaj lënde përfshihet edhe përpunimi i detajuar i MS Project si vegël themelore në Menaxhimin e Projekteve.

### Qëllimet

Studentët do të njoftohen me konceptet dhe teknikat e Menaxhimit të projekteve. Ata do të aftësohen ti identifikojnë, njohin dhe përdorin grupet e proceseve gjatë realizimit të projekteve. Nëpërmjet të rastit studimorë ata do ta demonstrojnë aftësinë që të shfrytëzojnë dhe vejnë në veprim dijenitë nga shkathtësia e menaxhimit të projekteve. Ata do të jenë në gjendje ti përcaktojnë fushat e veprimit të kryqëzuara me grupet e proceseve ashtu që të jenë në gjendje që me sukses ti menaxhojnë projektet e ndryshme. Pas përfundimit të lëndës ata duhet ta mësojnë mirë MS Project 2013 dhe implementimin e detaleve për një menaxhim optimal të projekteve.

### Rezultatet e pritura të lëndës

- Konkurojnë për projekt duke i përpiluar të gjitha dokumentet e nevojshme në pajtim me standardet dhe përvojat positive, me MS Preobject 2013, për menaxhim të projekteve
- Të planifikojnë dhe prezantojnë konceptualisht dhe në detale projektin e marrur  
Të jenë në gjendje ta krijojnë ekipin projektues dhe në harmoni dhe efektivitet optimal ta përfundojnë me sukses projektin
- Të komunikojnë dhe negociojnë me të gjithë akterët e projektit
- Të krijojnë plane rezerve dhe ta mbrojnë projektin nga rreziqet e natyrave të ndryshme
- Ta sigurojnë implementimin e standardeve dhe cilësisë së premtuar  
Ti dizajnojnë planet kohore e financiare dhe diagramet e ndryshme me veglat bashkëkohore për menaxhim të projekteve

## Programi

Java	Tema	Aktivitetet
1	Hyrje në Menaxhim të Projektit. Definimi i Menaxhimit të Projekteve.	Do të njoftoheni rreth konceptit të projektit dhe menaxhimit të projektit, si dhe se pse merremi me menaxhim të projekteve. Hyrje ne Microsoft Project.
2	Cikli i jetës së projektit dhe planifikimi i tij	Do të mësoni për pesë fazat e menaxhimit të projektit, të cilat do t'i përdorni gjatë gjithë semestrit dhe do t'i aplikoni gjatë zbatimit të projekteve.
3	Përkufizimi i projektit II/ Grupi i proceseve të fillimit	Do të mësoni se si bëhet specifikimi i objektivave të projektit, përcaktimi i resurseve paraprake, si dhe Identifikimi i mundësive dhe rreziqeve. Dekomponimi i aktiviteteve në nenaktivitete si dhe menyrat e nderlidhjes; Përcaktimi i resurseve përkatëse
4	Grupi i proceseve të planifikimit	Detajzimi i diagramit kohor me elementet e nevojshme të aktiviteteve periodike e joperiodike. (Takimi i startimit të projektit - kick of meeting, Takimi i progresit të projektit etj)
5	GP të Ekzekutimit	Dizajnimi i Diagramit kohor me detajzimin e aktiviteteve dhe nenaktiviteteve; Shtypja e diagrameve; Përcaktimi i ballines-header, i fundit - futer etj. Prezantimi i raporteve tjera si ai i resurseve, gjetja e tejangazhimeve të resurseve, dhe hekurrosja e angazhimit
6	GP të kontrollit dhe mbikëqyrjes dhe të përmbylljes	Definimi i detyrës projektuese në pajtim me projektin nga lenda Projekti Informatik 1. Krijimi i grupeve (jo më shumë se 3) dhe definimi i detyrave individuale të çdo anetari (në pjesën e raportimeve). Çdo anetare duhet të raportojë për konceptin e grupeve të proceseve të projektit të tyre.
7	Projekt propozimi –përpilimi i tij	Do të njoftoheni mbi atë çfarë duhet të përmbajë një projekt propozim
8	Test 1	Do të testoheni mbi njohuritë e fituara për temat e trajtuara
9	Menaxhimi i orarit (kohës), Menaxhimi i shpenzimeve, Resurseve	Vazhdimi i realizimit të projektit me analize të fusheveprimin e Cilesise dhe Resurseve. Vazhdimi i realizimit të projektit me analize të fusheveprimin të Komunikimit dhe Riskut; Dorezimi i projekteve
10	Menaxhimi i cilësisë	Vazhdimi i realizimit të projektit me analize të fusheveprimin e Prokurimit dhe Akterëve - Dorezimi i projekteve
11	Menaxhimi i komunikimit dhe menaxhimi i riskut/Përmbyllja	Prezantohet plani i komunikimit/plani i eliminimit të riskut
12	Prezantimi i projektit	Do të bëni prezantimin e projektit tuaj në ekip.

### Informata shpeshë 1:

Në këtë lëndë do të mësoni për teorinë e menaxhimit të projekteve dhe se si ta konkretizoni atë në praktikë duke zhvilluar një projekt autentik nga fillimi deri në fund. Përmes kësaj lënde ju do të fitoni njohuri mbi aftësitë e përdorura në menaxhimin e projektit dhe gjithashtu do të kuptoni se ku këto përshtaten në mjedisin biznesor. Ana praktike e lëndës do të jetë e dobishme për ju edhe në nivel personal, në përcaktimin, dizajnimin dhe ekzekutimin e një projekti real në ekip. Kjo lëndë ju aftëson me atributet që duhet t'i posedoni si të punësuar të ardhshëm. Në këtë mënyrë lënda synon të rrisë perspektivën tuaj për karrierë, duke i zhvilluar aftësitë që kërkojnë punëdhënësit. Për më tepër, kjo lëndë ju inkurajon të reflektoni mbi nivelin e të nxënies dhe nivelin aktual të aftësive tuaja, si dhe të përcaktoni objektivat për përmirësim të vazhdueshëm. Punëdhënësit kërkojnë që të diplomuarit të jenë jo vetëm ekspertë profesionalë, por edhe të reflektojnë e të jenë kritik dhe të dëshmojnë aftësi të shkëlqyera komunikuese e ekipore. Të gjitha këto aftësi do të praktikohen në këtë lëndë përmes punës praktike, ligjëratave e vlerësimeve, të cilat janë një pasqyrë reale të nivelit të aftësive tuaja. Ju do të njiheni me mjetet dhe teknikat efektive për komunikim verbal dhe të shkruar,

menaxhimit e kones dhe negocimit.

## Informata shesë 2:

MS Project, MS Word, MS Excel, MS Power Point, MS Access, MS Visio, MS Visual Studio, MS SQL Server

### Vlerësimi:

Nr.	Lloji	Përqindja	Oblig.	Përshkrimi
1	Kolokvium	35	Po	Realizimi i Projektit
2	Kolokvium	35	Po	Testi 1
3	Detyra	25	Po	Projekti final ne MS Project. Kompletimi i PID dokumentit, Raporti Narrativ
4	Pjesëmarrja	5		Pjesemarrja aktive ne ligjerata dhe ushtrime

### Kushtet e përsëritjes:

Studenti obligohet të përmbushë me sukses kërkesat e lëndës përgjatë 3 afateve. Nëse studenti nuk i përmbushë këto kërkesa në afatin e dhënë, atëherë atij i llogaritet se ka shpenzuar afatin brenda vitit akademik. Nëse pas 3 tentimeve, studenti nuk e kalon lëndën, atëherë ai obligohet të dëgjojë sërish lëndën në vitin vijues akademik. Pra, pa përmbushjen e kërkesave të lëndës studenti nuk mund ta kalojë lëndën.

### Burimet:

- Literatura themelore, • A guide to the Project Management body of knowledge edition 6 2017 by PMI Inc  
Literatura tjetër: • H. (2010) Project Management, Fourth Edition. Harlow: Financial Times Prentice Hall. • Project Management Professional, by Mitchel Nevel. • 5 phase Project Management by Joseph Weis, Robert Wisocki • Robert Wisocky: Efective Project Management Traditional, Adaptive Extreme • J.W.Weiss & R.K. Wysocki :5-Phase of Project Management (A Practical Planing & Implementation Guide) • Robert K. Wysocki: Effective Project Management, (Traditional, Adaptive, Extreme: 2007 • James P. Lewis: Fundamentals of Project Management, Third edition 2007. • MS Project 20013 • MS Project 20013 tutorial

### Ndërtimi i ECTS-ve

Aktiviteti	Nr i oreve per Aktivitetin	
Ligjerata:	2	
Ushtrime:	2	
L+U:	60	
Seminar/praktike.:	0	
Studim i vazhdushem:	0	
Pregaditja e Provimit:	0	
Pjesemarrja ne teste:	0	
Pjesemarrja ne provimin final:	0	
Me profesorin dhe asistentin:	0	
Total Ore:	0	
ECTS:	6	